




Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo




Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Orahovac

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë



Datë/e	27.11.2020	-III-	Nr. i prot Br. prot.	48	Më Dt.	12-01	2021
Referencë/e	RAHOVEC - ORAHOVAC						
Për/To:	Kryetarin e Komunës- z. Smajl Latifi						
CC:	Kuvendit të Komunës së Rahovecit						
Përmes/Through:	Drejtperdrejt						
Nga/From :	z. Afrim Oruqi Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë						
Subjekt/Subject:	Plani i punës për vitin 2021						



Plani i punës për vitin 2021

**Nga: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë**

Fillimi i vitit të ri, do të filloj me qasje në detyrat e reja dhe obligimet e mbetura nga viti paraprak.

Qysh në fillim të vitit 2021 do t'i qasem punës në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara nga Kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale dhe Statutin e Komunës së Rahovecit.

**PRIORITETET e vitit 2021**

Prioritet kryesor gjatë vitit 2021 do të fokusohet në shërbime cilësore në përputhje me afatet kohore dhe të unifikuara ligjërisht.

Qëllimi kryesor i drejtorisë do të jetë i fokusuar në shërbime komfor akteve juridike.

Vazhdimi i evidentimit dhe lirimit të pronave të uzurpuara në nivel të komunës.



Gjeoreferencimi i hartave- planeve gjeodezike të pa përfunduara.

Vazhdimi i inventarizimit të dokumentacionit dhe skenimi masiv i dokumentacionit të pa skanuar.

Shpronësimi i pronave private për hapje të rrugëve publike në nivel të Komunës.

SFIDAT e vitit 2021

Themelimi i komisionit për komosacion

Vazhdimi i migrimit të zonave kadastrale në komosacion të zonave që nuk janë të migruara në nivel të komunës.

Rindërtimi i zonave kadastrale në bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës.

Dua të theksoj se në kuadër të Drejtorisë ekzistojnë dy sektorë:

**Spektori për Kadastër dhe Pronë dhe**

**Spektori për Gjeodezi**

Numri i punëtorëve në këtë drejtori është me sa vijon;

Gjithsej 9 punëtorë, ku prej tyre 2 janë me përgatitje të lartë shkollore (jurist-gjeodete), 5 janë gjeodetë, ku 4 prej tyre janë me përgatitje të mesme, 1 referentë me përgatitje te lart juridike dhe 1 vozitës.

**Spektori për Kadastër dhe Pronë**, gjate periudhës një vjeqare parashihet që të pranoj dhe kryej më shumë se 1300 lëndë.

**Spektori për Gjeodezi** parashihet që të pranojë dhe zgjidhë mbi 620 lëndë.

Duke filluar nga muaji shkurt i vitit 2021 pritet që të ketë rritje të kërkesave për nxjerrjen e çertifikatave pronësore nga ana e fermerëve për aplikim në kuadër të subvencioneve që pritet t'ju ndajë Qeveria e Kosovës, këtë proces do ta menaxhojmë me shumë kujdes duke e rritur stafin mbështetës dhe do të jemi në shërbim të qytetarëve me shumë profesionalizëm dhe në kohë reale.

Vlen të përmendet sektori i gjeodezisë për punën e tyre që do ta kenë në terren, si dhe shërbimi pronësoro juridik për angazhimin e dhënë në përgatitjen e akteve si për nevoja të Kuvendit të Komunës ashtu edhe përgatitjen e akteve për persona fizik dhe juridik.



Do të vazhdojmë me përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm në lidhje me evidentimin e pronave si ato komunale dhe ato private që janë vendëreniet e dëshmorëve të kombit me qëllim që këto parcela t'i shpallim zona me interes të veçantë, kjo mbetet sfidë që të përfundohen deri në fillim të vitit 2021.

Gjatë vitit 2021 nuk do të mungojë edhe qasja ndaj detyrave të tjera, si në sektorin e gjeodezisë ashtu edhe në atë të kadastrës dhe pronës, ku vlen të cekën:

- Propozim vendimet për seancat e Kuvendit Komunal
- Përgatitja e lëndëve për gjykatë dhe subjekteve të tjera të përfshira në zbatimin e ligjit.
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe personave juridik.
- Punët e gjeodezisë inxhinierisë për nevojat e Kuvendit Komunal dhe palëve të tjera
- Matjet kadastrale për vërtetimin e uzurpimeve arbitrare,
- Përgatitja e Aktvendimeve për uzurpimet arbitrare,
- Punë të tjera sipas planit.

❖ **Me propozim të Kryetarit të Komunës, drejtuar Kuvendit të Komunës, do të bëhet shpallja e interesit të përgjithshëm të pronave komunale për zhvillim ekonomik të Komunës.**

❖ **Detyrat tjera të Drejtorisë**

- Përgatitja e akt dokumentit për angazhimin e gjeodetëve Komunal jashtë drejtorisë.
- Përgatitja e akteve ndaj uzurpatorëve në nivel të Komunës
- Dalja në terren e Shërbimit pronëso-ro-juridik, me kërkesë të Drejtorisë për Inspeksion.
- Dalja e gjeodetëve në terren për matjen e rrugëve në nivel Komune.

Me respekt!